



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.72, Datë 30.03.2023

PËR

**“MIRATIMIN E KOMENTEVE DHE KUNDËRSHTIMEVE NDAJ RAPORTIT TË VLERËSIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE QË KANË APLIKUAR PËR PRANIMIN NË FORMIMIN FILLESTAR, NË VITIN AKADEMIK 2023-2024”, PROFILI PROKUROR, TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, nenin 30, pika 4 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 189 dhe 190 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e komenteve dhe kundërshtimeve ndaj Raportit të vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar, në vitin akademik 2023-2024, profil prokuror, të Shkollës së Magjistraturës, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më 30.03.2023.

KRYETARI

Alfred Balla

